Rregullorja (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëvë të Brendshme përcakton numrin e përgjithshëm të të punësuarve në Ministrinë e Punëve të Brendshme, gjithsej treqind e nëntëdhjetë e pesë (395)[25] nga tetëqind e tridhjetë e një (831) sa ishte paraparë me Rregulloren (QRK) Nr. 11/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 36/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme[26].

Ministria e Punëve të Brendshme deri në fuzionimin me Ministrinë e Administratës Publike përbëhej gjithsej nga shtatë (7) Departamente dhe tridhjetë (30) Divizione ndërsa rregullorja e lartpërmendur e cila shfuqizon njëherazi rregulloren e mëparshme parasheh përbërjen si në vijim: Kabineti i Ministrit, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, trembëdhjetë (13) Departamente, pesëdhjetë e një (51) Divizione.

Pozitat drejtuese

Rregullorja (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëvë të Brendshme ani pse është në fuqi që nga viti 2021, e njejta nuk ka gjetur implementim. Andaj, shërbimi civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme pavarësisht riogranizimit të brendshëm vazhdon të veproj me bazë në rregulloren e shfuqizuar pjesërisht tashmë.

Me sa u tha më lart, Ministria e Punëve të Brendshme nga 7 departamentet, 4 rezulton të i ketë pozita të rregullta[27] udhëheqëse, ndërsa 3 pozita ushtrohen nga zëvendësues si dhe Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, Sekretariati i Strategjive udhëhiqet nga pozita të rregullta udhëheqëse.
Ndërsa, sa i përket njësive organizative, nga 30 divizionet, 19 nga to figurojnë të jenë pozita të rregullta, 9 pozita ushtrohen nga zëvendësues, ndërsa për 2 pozita nuk ka të dhëna. Sa i përket njësive organizative në rezultate janë përfshirë edhe Qendra për Azilkërkues e cila udhëhiqet nga pozitë e rregullt dhe Qendra për Mbajtjen e të Huajve e udhëhequr nga zëvendësues[28].

24 Rregullore nr. 2005/53 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2011/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Shtojca XVI, (e shfuqizuar). E qasshme në: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2005regs/RA2005_53.pdf

25 Rregullore (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëvë të Brendshme, Neni 4, prg. 4.2, E qasshme në: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=36587

26 Rregullore (QRK) Nr. 11/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 36/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Neni 2, prg, 2.1. E qasshme në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=36587

27 Pozitë e rregullt nënkupton kur pozita ushtrohet nga nëpunësi civil I cili është emëruar dhe ka një akt emërim të ligjshëm për ushtrimin e asaj pozite.

28 Informata të ofruara nga MPB, pas kërkesës së GLPS për qasje në dokumente publike;

Gjendja pas ristrukturimit

Rregullorja për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme[29] ka hyrë në fuqi më 29 janar të vitit 2021 por në praktikë edhe dy (2) vite pas tashmë, nuk është ndërmarrë ndonjë veprim konkret për implementimin e saj. E njëjta është plotësuar/ndryshuar në mars të vitit 2023.[30] Ky ndryshim ka konsistuar nw ndryshimin e numrit te te punesuarve ne disa departamente dhe divizione. Sipas të dhënave të ofruara nga ministria dhe të gjeturave, 2 pozita të drejtorëve të departamenteve dhe 8 pozita të udhëheqësve të divizionit do t`i nënshtrohen ristrukturimit. Kjo ministri nuk ka ofruar të dhëna të përditësuara marrë parasysh rregulloren e re.

Tabela [...]

Niveli Organizativ/ Departamenti	Niveli organizativ/Divizioni	Nëpunësit sipas rregulloreve	Nëpunësit aktual
Kabineti I Ministrit			
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm	Divizioni i Auditimit të Brendshëm	4	4
	Divizioni i Prokurimit	8	10
	Divizioni për Komunikim Publik	4	5
	Divizioni i Auditimit të Brendshëm	7	5
	Divizioni për Buxhet dhe Financa	23	12
	Divizioni i Burimeve Njerëzore	10	12
	Divizioni për Menaxhimin e Kontratave	3	3
Departamenti për Siguri Publike	Divizioni për Armë, Municion dhe Eksplozivë	10	8
	Divizioni për Sigurimin e Aviacionit Civil	4	2
	Divizioni për Shërbimet Private të Sigurisë	5	5
	Divizioni për Siguri në Bashkësi	3	1
	Divizioni për Hulumtim dhe Statistika	4	3

29 Rregullorja (zkm) nr. 01/2021 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme. E qasshme në: ActDetail.aspx (rks-gov.net)

30 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=36587

● Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim	● Divizioni për Shtetësi	9	8
	Divizioni për Azil	4	3
	● Divizioni për të Huaj	10	6
	Divizioni për Ripranim dhe Kthim	5	5
	● Divizioni për Menaxhimin e të Dhënave të Migrimit	5	4
	Qendra e Pritjes së Përkohshme	3	2
	Qendra për Azilkërkues	5	5
	● Qendra për Mbajtjen e të Huajve	4	2
● Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar	Divizioni për Pranim dhe Akomodim	3	3
	● Divizioni për Menaxhim Rajonal	8	9
	Divizioni për Shqyrtimin e Kërkesave	3	3
	● Divizioni për Bashkëpunim me Organizata Vendore dhe Ndërkombëtare	2	2
Departamenti për Administrim të Sistemeve dhe Komunikimeve	Divizioni për Administrim të Sistemit dhe Rrjetit	3	2
	Divizioni për Administrim të Aplikacioneve dhe Bazave të të Dhënave	4	4
	● Divizioni për Përkrahje të Shfrytëzuesve	3	3
● Departamenti për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave	● Divizioni për Integrime Evropiane	3	2
	● Divizioni për Koordinim të Politikave	3	1
Departamenti Ligjor	Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit	6	4
	Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit	3	3
	Divizioni i TI-së dhe Shërbimeve Logjistike	15	33
Sekretariati i Strategjive		6	4

● Ushtrues i detyrës Totali 178 171

MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFERAVE (MFPT)

Historiku

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është themeluar me hyrjen në fuqi të
Rregullores së UNMIK-ut 2011/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.[31] Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve që nga themelimi e gjerë më sot ka pësuar ndryshime sa i përket emërtimit por edhe plotësim-ndryshime sa i përket fushëveprimit varësisht nga programi qeverisës i partive në pushtet për periudhat gjegjëse. Si e tillë fillimisht është emërtuar Ministria për Ekonomi dhe Financa, më pas Ministria e Financave, ndërsa tashmë emërtohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Organizimi

Rregullorja (QRK) Nr. 17/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Financave përcakton numrin e përgjithshëm të të punësuarve në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, gjithsej dyqind e tetë (208)[32].

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përbëhet nga Kabienti i Ministrit, Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, dymbëdhjetë (12) departamente, tridhjetë e tre (33) divizione.

Pozitat drejtuese

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, nga 12 departamentet – zyrat, 7 rezultojnë të jenë pozita të rregullta[33] udhëheqëse dhe 4 pozita janë me ushtrues detyre duke përfshirë gjithashtu Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm që udhëhiqet nga ushtrues që 4 vite.
Ndërsa, sa i përket njësive organizative, nga 33 divizionet, 18 nga to figurojnë të jenë pozita të rregullta, 12 pozita ushtrohen nga ushtrues detyra dhe për 3 pozita nuk ka të dhëna[34].

Gjendja pas ristrukturimit

Ministria ka miratuar një rregullore të re në vitin 2023 e cila parasheh një strukturë të ndryshme nga aktualja. Kjo ministri ka ofruar informata lidhur me gjendjen aktuale pas ristrukturimit të kësaj ministrie.[35]

Tabela e e ish- Ministrisë së Financave, tash MFPT (para riorganizimit të Qeverisë) [...]

31 Rregullore e UNMIK-ut 2011/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Shtojca II (e shfuqizuar), E qasshme në: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2001regs/RA2001_19.pdf

32 Rregullore (QRK) Nr. 17/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Financave, Neni 3, prg.2. E qasshme në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15803

33 Pozitë e rregulltë nënkupton kur pozita ushtrohet nga nëpunësi civil i cili është emëruar dhe ka një akt emërim të ligjshëm për ushtrimin e asaj pozite.

34 Informata të ofruara nga MPB, pas kërkesës së GLPS për qasje në dokumente zyrtare;

35 Rregullore (Zkm) Nr. 02/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e

Vendeve të Punës në Ministrinë E Financave, Punës dhe Transfereve: e qasshme në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71784

Niveli Organizativ/ Departamenti	Niveli organizativ/Divizioni	Nëpunësit sipas rregulloreve	Nëpunësit aktual
● **Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm**	● Divizioni për Raportim Financiar	5	5
	Divizioni i Prokurimit	3	6
	Divizioni për Komunikim Publik	4	7
	Divizioni për Buxhet dhe Financa	6	15
Departamenti i Buxhetit	Divizioni i Buxhetit Qendror	17	15
	Divizioni i Buxhetit Komunal	12	9
	Divizioni për Ekzekutimin e Buxhetit dhe Sistemeve	3	3
	Divizioni për Politika Buxhetore, Koordinim dhe Raportim	4	4
Departamenti i Politikave Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar	● Divizioni i Politikave Makroekonomike	6	10
	● Divizioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar	3	5
Departamenti i Politikave Fiskale dhe Tregjeve Financiare	● Divizioni i Politikave Fiskale	4	8
	● Divizioni i Tregjeve Financiare	3	-
● **Departamenti i Tatimit në Pronë**	Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për hpronësime	5	6
	● Divizioni për Inspektim	4	5
	Divizioni për Vlerësim, Standarde, Zhvillim dhe Operim të Programit		8
Departamenti Qendror Harmonizues	● Divizioni Qendror për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm	6	8
	Divizioni Qendror Harmonizues për Menaxhimin Financiar dhe Kontroll	5	5
Departamenti i Auditimit të Brendshëm	● Divizioni për Auditimin e Brendshëm brenda institucionit	3	
	Divizioni për Auditimin e Brendshëm jashtë institucionit.	3	5
● **Departamenti Qendror për Partneritet Publiko Privat**	● Divizioni për Koordinim dhe Ngritje të Kapaciteteve	3	2
	● Divizioni për Vlerësimin e Projekteve të Partneritetit Publiko Privat	3	2
	Divizioni për Monitorimin e Kontratave të Partneritetit Publiko Privat	3	2
● **Departamenti i Ndihmës Shtetërore**	● Divizioni për Vlerësimin e Ndihmës Shtetërore	3	4
	● Divizioni për Mbikëqyrjen e Kontrollit të Ndihmës Shtetërore	3	3

Departamenti për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave	Divizioni për Integrime Evropiane	2	4
	Divizioni për Koordinim të Politikave	2	2
● **Departamenti Ligjor**	Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit	6	7
	● Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të bështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit	2	5
Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative të MF	Divizioni për Infrastrukturë të TI	3	6
	Divizioni për Operacione të TI-së	4	5
	● Divizioni për Menaxhim të Aplikacioneve	4	6
Departamenti për shërbime të përgjithshme	Divizioni i Burimeve Njerëzore	10	7
	Divizioni I Logjistikes	20	24
● Ushtrues i detyrës	Totali	164	203

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

Historiku

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është themeluar me hyrjen në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2011/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë[36].

Organizimi

Rregullorja (QRK) Nr. 14/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale përcakton numrin e përgjithshëm të të punësuarve në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, gjithsej katërqind e shtatëdhjetë (470)[37].

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përbëhet nga Kabineti i Ministrit, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, nga shtatë (7) Departamente dhe njëzetë e shtatë (29) Divizione[38].

Pozitat drejtuese

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nga 7 departamentet rezulton të ketë 4 pozita të rregullta[39] udhëheqëse dhe 3 pozita janë udhëhiqen nga ushtrues detyre.
Ndërsa, sa i përket njësive organizative, nga 29 divizionet, 22 figurojnë të jenë

36 Rregullore e UNMIK-ut 2011/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Shtojca VII (e shfuqizuar), E qasshme në: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2001regs/RA2001_19.pdf

37 Rregullorja (QRK) Nr. 14/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale Neni 3, prg. 2, E qasshme në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11312

38 *Ibid.*

39 Pozitë e rregulltë nënkupton kur pozita ushtrohet nga nëpunësi civil i cili është emëruar dhe ka një akt emërim të ligjshëm për ushtrimin e asaj pozite.

pozita të rregullta, ndërsa 7 pozita ushtrohen nga zëvendësues[40].

Gjendja pas ristrukturimit

Rregullorja për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ka hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2015, mirëpo e njëjta i është nënshtruar ristrukturimit pas riorganizimit të qeverisë dhe hyrjes në fuqi të rregullores së re në vitin 2023, pas bashkimit me Ministrinë e Financave. Njëjtë, si për Ministrine e Financave, as për këtë pjesë nuk ka të dhëna sipas rregullores së re.

Tabela e e ish- Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, tash MFPT (para riorganizimit të Qeverisë)

Niveli Organizativ/ Departamenti	Niveli organizativ/Divizioni	Nëpunësit sipas rregulloreve	Nëpunësit aktual
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm	Divizioni i Auditimit të Brendshëm	3	4
	Divizioni për Mbështetje Administrative të Këshillit të Përgjithshem për Shërbime Sociale dhe Familjare (KPSHSF)	2	1
	Divizioni i Prokurimit;	5	5
	Divizioni për Komunikim Publik	4	4
	Divizioni i për Çështje të Trashëgimisë së Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK)	3	5
Departamenti për Punë dhe Punësim	Divizioni i politikave të punësimit dhe aftësimit profesional	4	4
	Divizioni për marrëdhënie në punë, dialogut social, sigurinë dhe shëndetinë në punë	4	4
	Drejtori I Departamentit me Asistent		2
Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjare	Divizioni për Politika Sociale	10	7
	Divizioni për Planifikim dhe Përfshirje Sociale	8	7
	Divizioni për Shërbime Sociale	9	7
	Divizioni për Ndihma Sociale	11	9
	Divizioni për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar	5	3
Departamenti i Pensioneve	Divizioni për Politika Pensionale	5	3
	Divizioni për Skema Pensionale	16	13
	Divizioni për Pensione të Jashtme	12	11
	Divizioni për Monitorimin dhe Kontroll të Zyrave të Pensioneve	5	3
	Divizioni i Komisioneve Mjekësore	10	8

40 Informata të ofruara nga MPB, pas kërkesës së GLPS për qasje në dokumente zyrtare;

● **Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës**	● Divizioni i Skemave për Kategoritë e Luftës	12	12
	Divizioni për Realizimin e të Drejtave	2	2
	Divizioni i Monitorimin e e Skemave të Pensioneve dhe Beneficioneve për Kategoritë e Luftës	2	2
● **Departamenti për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave**	Divizioni për Integrime Evropiane	3	3
	● Divizioni për Koordinim të Politikave	3	2
	Divizioni për Marrëveshje të Sigurimeve Sociale dhe Punësim	3	2
Departamenti Ligjor	● Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit	3	3
	Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit	3	2
	Divizioni për Shqyrtimin e Parashtresave dhe Ankesave	4	4
Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme	Divizioni për Buxhet dhe Financa	12	12
	Divizioni i Burimeve Njerëzore	12	7
	● Divizioni i TI-së dhe Shërbimeve Logjistike	6	5
● Ushtrues i detyrës		Totali 181	156

6. Zyra e Kryeministrit

Historiku

Zyra e Kryeministrit (ZKM) funksion si e bashkuar me fushën e integrimit evropian nga qershori i vitit 2020, pas bashkimit të Zyrës së Kryeministrit me Ministrinë e Integrimit Evropian. Ky bashkim ka ndodhur me Vendimin (nr. 07-V-014) të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, më pas e pasqyruar edhe në Rregulloren (QRK) – nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeminisitrit dhe ministrive.[41]

Para këtij bashkimi, Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Integrimit Evropian kanë vepruar ndarazi.

Zyra e Kryeministrit është themeluar në vitin 2001, ku atëherë kishte funksionuar si Kabinet i Kryeministrit. Kabineti i Kryeministrit, përveç këshilltarëve politikë, përfshinte zyrat në vijim: Zyra për shërbimet e ndihmës juridike, Zyra e informimit publik, Zyra e këshilldhënies për qeverisje të mirë, të drejtat e njeriut, mundësitë e barabarta dhe për çështjet gjinore, Zyra këshilldhënëse e komuniteteve, si dhe Komisioni për emërimin e funksionarëve. Në vitin 2011, u miratuar Rregullorja 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, e cila përcaktoi funksionet e Zyrës së Kryeministrit, ku më pas në vitin 2013 u miratua

41 Rregullore (QRK) – nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, (e shfuqizuar), https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=28172

Rregullorja (QRK) - nr. 16/2013 për stukturën organizative të Zyrës së Kryeministrit, e cila përcaktoi strukturën e organizimit të Zyrës së Kryeministrit.[42] Kjo rregullore është ndryshuar me Rregulloren (QRK) - nr. 08/2019, me Rregulloren (QRK) -nr. 11/2016, me Rregulloren (QRK) – nr. 02/2017 dhe me Rregulloren (QRK) nr. – 02/2019. Në vitin 2020, Rregullorja nr. 02/2011 u shfuqizua në tërësi me Rregulloren (ZKM) – nr. 01/2020 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Zyrën e Kryeministrit, e cila reflektoi ndryshimet në fushëveprimin e Zyrës së Kryeministrit pas bashkimit me fushën e përgjegjësisë së integrimit evropian.

Ministria e Integrimit Evropian është themeluar në vitin 2010 me vendimin e Qeverisë nr. 6/121 të datës 22 prill 2010 për fushëveprimin e Ministrisë së Integrimit Evropian.[43] Fillimisht, kjo fushë e përgjegjësisë, që nga viti 2006 u realizua nga Agjencia për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integrimit Eropian. Vendimi për themelimin e Agjencisë për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integrimit Evropian ka hyrë në fuqi me datën 8 tetor 2008 me nënshkrimin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Si synim i Agjencisë ishte përmirësimi i mënyrës dhe procedurave se si Qeveria dhe partnerët zhvillimor punojnë së bashku për të rritur efikasitetin e asistencës së jashtme me qëllim për të lehtësuar synimet e përbashkta dhe plotësuese të zhvillimit dhe integrimit evropian. Kjo Agjenci ka funksionuar në kuadër të Zyrës së Kryeministrit si organ qendror me përgjegjësi për koordinimin e donatorëve dhe veprimeve të Qeverisë për integrim Evropian.[44] Pas themelimit si Ministri, Ministria e Integrimit Evropian kishte kompetencë, ndër të tjera, edhe bashkërendimin e punës dhe monitorimin e aktiviteteve të institucioneve të Qeverisë në kuadër të Procesit të Stabilizim – Asociimit. Në vitin 2012, u shfuqizua Rregullorja e vitit 2010 dhe u miratua Rregullorja (QRK) - nr. 32/2012 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Integrimit Evropian.[45] Kjo rregullore u ndryshua dy (2) herë, me Rregulloren (QRK) – nr. 27/2013 dhe me Rregulloren (QRK) -Nr. 08/2019 deri në shfuqizimin e tërësishëm nga Rregullorja (ZKM) nr. 01/2020.

Organizimi

Sipas Rregullores (ZKM) Nr. 01/2020 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Zyrën e Kryeministrit[46], ZKM ka 16 zyre (niveli i departamenteve), 40 divizione dhe 1 njësi.

Deri në bashkim, **Zyra e Kryeministrit** kishte 11 zyre (në nivel të departamenteve), 8 zyre, të cilat i përgjigjeshin Kryeministrit drejtpërdrejtë (udhëhësi ishte i emëruar politik, ndërsa zyrtarët shërbyes civil), 3 divizione dhe 3 njësi, të cilat i përgjigjeshin Sekretarit të Përgjithshëm (Koordinatori për Integrim Evropian, Zyrtari i lartë certifikues dhe Arkivi i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ndërsa, **Ministria e Integrimit Evropian** kishte 7 departamente dhe 21 divizione.

Megjithatë, sipas njoftimit të ZKM, Rregullorja (ZKM) – nr. 01/2020 nuk është në zbatim bazuar në rekomandimin e Komisionit të pavarur, i cili ka dhënë rekomandimin

42 Rregullore nr. 16/2013 për strukturën organizative të Zyrës së Kryeministrit, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8695

43 Vendim i Qeverisë nr. 6/121 i datë 22.04.2010 për fushëveprimin e Ministrisë së Integrimit Evropian, https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Vendimet_e_Mbledhjes_se_121-te_te_Qeverise_2010.pdf

44 Për Agjencinë, https://web.archive.org/web/20100612175118/http://acdei-ks.org/?id=47&mid=44&mid=44

45 Rregullorja Nr. 32/2012 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Integrimit Evropian, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10311

46 Rregullore (ZKM) –Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=34004

me nr. 018/5 të datës 15.07.2021.[47]

Pozitat udhëheqëse

Meqenëse, rregullorja e re nuk është në zbatim, nga 19 departamentet – zyrat 16 pozita udhëheqëse janë të rregullta, ndërsa 1 pozitë ushtrohet nga zëvendësues, si dhe për dy zyre, të cilat sipas rregullores së paraprake kanë qenë pozita që udhëhiqen nga të emëruarit politik nuk ka informata. Ndërsa nga 40 divizione apo njësi ekuivalente me divizionin (vlen të theksohet se në ZKM ka pozita koordinator), 5 divizione udhëhiqen nga zëvendësues, për 9 divizione nuk ka informata dhe të tjerat udhëhiqen nga pozita të rregullta.[48]

Gjendja pas ristrukturimit

Rregullorja për organizimin e brendshëm të Zyrës së Kryeministrit[49] ka hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2020, por nuk është në zbatim. Sipas gjetjeve nga analiza e bërë, 1 pozitë e drejtorit do të shuhet në tërësi, për arsye se Departamenti i së Drejtës së BE-së, sipas Rregullores (ZKM) – nr. 01/2020 është pjesë e Zyrës Ligjore, 1 pozitë e drejtorit do t'i nënshtrohet ristrukturimit, si dhe 11 pozita të udhëheqësit të divizionit do t'i nënshtrohen ristrukturimit. Zyra e Kryeministrit nuk ka ofruar të dhëna të përditësuara.

Niveli Organizativ/ Departamenti	Niveli organizativ/Divizioni	Nëpunësit sipas rregulloreve	Nëpunësit aktual
Kabineti i Kryeministrit			72
● Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm	Njësia për Auditim të Brendshëm (NJAB)	3	2
	Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (DMBNJ)	4	3
	Koordinatori për integrim evropian		1
	Njësia e Arkivit		1
Zyra Ligjore (ZL)	● Koordinator	3	1
			11
			6

47 Njoftimi i pranuar nga ZKM, pas kërkesës së GLPS.

48 Informata të ofruara nga Zyra e Kryeministrit, pas kërkesës së GLPS për qasje në dokumente zyrtare;

49 Rregullore (ZKM) Nr. 01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, miratuar nga Kryeministri me Vendimin nr. 214/2022, të datës 01.02.2022.

Sekretariati Koordinues i Qeverisë (SKQ)	Divizioni për Organizimin e Mbledhjeve të Qeverisë dhe Koordinim me Kuvendim	5	2
	Divizioni për Koordinim të Politikave	7	8
	Divizoni për Mbështetje të Trupave Qeveritar		2
	Njësia për Ekspertizë	3	1
	Divizioni për Rregullim më të mirë		1
Zyra për Qeverisje të Mirë	Koordinator e zyrës për qeverisje të mirë	4	1
			6
Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare (ZPGZ)	Koordinator I zyrës	3	4
Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK)		3	2
Zyra e Administratës Qëndrore	Divizioni për Teknologji Informative	5	5
	Divizioni për Përkthime	4	2
	Njësia e Transportit		5
Zyra për Buxhet dhe Financa (ZBF)	Divizioni për Buxhet	3	1
	Divizioni për Financa	4	3
Zyra e ish-Kryeministrit	Ish KM Mustafa - stafi, ish KM Haradinaj -stafi dhe ish KM Hoti-stafi		8
Zyra e Prokurimit	Koordinator për Menaxhimin e Kontratave	3	1
			1
Zyra për Komunikim me publikun	Koordinator i zyrës	5	4
Zyra e Komisionerit për Gjuhët	Koordinator për Komunikime		1
	Koordinator për Hetime		1
	Koordinator për sigurimin e zbatueshmerisë		1
Agjencia për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore	Shefi I sektorit për mbrojtje nga rrezatimi		4
Njësia e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur	Udhëheqës i Njësisë së Komisionit Qeveritar		3
Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA)	Kryesuesi dhe anëtarët me mandat 5 vjeçar		4

Niveli Organizativ/ Departamenti	Niveli organizativ/Divizioni	Nëpunësit sipas rregulloreve	Nëpunësit aktual
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm	Divizioni i Auditimit të Brendshëm	3	1
	Divizioni i Prokurimit;	3	1
	Divizioni i Komunikimit Publik	3	3
Departamenti i Koordiniminit të Procesit të Stabilizim Asocimit			5
Departamenti i Kritereve Politike	Divizioni i Kritereve Administrative dhe Politike	3	1
	Divizioni i Gjyqësorit dhe të Drejtave Themelore	3	2
	Divizioni i Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë	3	2
Departamenti i Kritereve Ekonomike dhe Tregut të Brendshëm	Divizioni i Ekonomisë, Zhvillimit Rajonal dhe Statistika	3	0
	Divizioni i Tregut të Brendshëm dhe Tregtisë	4	3
	Divizioni i Politikave Sociale, Arsimit dhe Shëndetësisë	3	2
Departamenti i Politikave Sektoriale	Divizioni i Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural dhe Sigurisë së Ushqimit	3	3
	Divizioni i Mjedisit, Energjisë dhe Transportit	4	2
Departamenti i Asistencës Zhvillimore	Divizioni i Planifikimit dhe Koordinimit	3	0
	Divizioni i Administratës Publike dhe Sundimit të Ligjit	4	3
	Divizioni i Zhvillimit Ekonomik dhe Social	5	2
Departamenti i së Drejtës së BE-së	Divizioni i së drejtës së BE për Tregun e Brendshëm dhe Ekonomi	3	0
	Divizioni i së drejtës së BE-së për Drejtësi, Pune të Brendshme dhe Administratë Publike	3	0
	Divizioni per Ceshtje Ligjore te Be-se	5	4
	Divizioni i Koordinimit dhe Përkthimit dhe Terminologjisë së Acquis të BE-së	3	0

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të	Divizioni i Burimeve Njerëzore	3	1
	Divizioni i Buxhetit dhe Financave	6	4
	Divizioni i TI dhe Shërbimeve Logjistike	9	5

7. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës

Historiku

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) funksion si e tillë nga shkurti i vitit 2020, pas bashkimit të Ministrisë së punëve të Jashtme me atë të Diasporës. Ky bashkim ka ndodhur me Vendimin (nr. 07-V-005) të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, më pas e pasqyruar edhe në Rregulloren (QRK) – nr. 05/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive.[50]

Para bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme me atë të Diasporës, këto ministri kanë vepruar ndarazi.

Ministria e Punëve të Jashtme është themeluar themeluar në vitin 2008 me anë të Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës.[51] Organizimi, ndarja e punëve dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Punëve të Jashtme fillimisht janë rregulluar me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2008 për organizimin dhe strukturimin e brendshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme.[52] Pastaj, kjo rregullore u ndryshua në vitin 2013, me të cilën u shtua numri i departamenteve – strukturave organizative në 15.

Ministria e Diasporës është themeluar në vitin 2011 me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të marrë në mbledhjen e 15-të, më 18 maj 2011. Në vitin 2017, Ministrisë së Diasporës i është shtuar edhe fusha e përgjegjësisë së investimeve strategjike, përmes Vendimit nr. 06-V-005 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë, e cila u reflektua në Rregulloren nr. 16/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive. Në këtë rregullore u definuan kompetencat e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike dhe më pas organizimi i brendshëm dhe sistematzimi i vendeve të punës i kësaj ministrie u rregullua me Rregulloren (QRK) nr. 03/2018.[53] Si Ministri e Diasporës dhe Investimeve Strategjike funksionoi deri në shkurt 2020 kur u bashkua përfundimisht me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Organizimi

Sipas Rregullores (ZKM) Nr. 01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe

50 Rregullore (QRK) – nr. 05/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, (e shfuqizuar), https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=27179

51 Ligji nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe shërbimin diplomatik të Republikës së Kosovës, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2519

52 Udhëzim Administrativ Nr. 01/2008 për organizimin dhe strukturimin e brendshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme (i shfuqizuar), https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7761

53 Rregullore (QRK) Nr. 03/2018 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16036

Diasporës[54], MPJD ka 13 departamente, 35 divizione, 2 njësi dhe 1 Qendër.

Deri në bashkim, **Ministria e Punëve të Jashtme** kishte 12 departamente dhe 12 divizione, ndërsa **Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike** kishte 6 departamente dhe 16 divizione.

Pozitat udhëheqëse

Nga 13 departamente, të gjitha pozitat udhëhiqen me pozita të rregullta, ku vetëm pozita e Sekretarit të Përgjithshëm udhëhiqet me zëvendësues.[55] Nga 35 divizione, 19 udhëhiqen me pozita të rregullta, ndërsa për 16 tjera nuk kemi informata, të gjitha njësitë udhëhiqen nga pozita të rregullta, si dhe për Qendrën për Menaxhimin e Krizave nuk ka informata.

Gjendja pas ristrukturimit

Rregullorja për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës[56] ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2022, por në praktikë nuk është ndërmarr ndonjë veprim për zbatimin e saj. Sipas gjetjeve nga analiza e bërë, 1 pozitë e drejtorit të departamentit dhe 5 pozita të udhëheqësve të divizionit do t`i nënshtrohen ristrukturimit.

Niveli Organizativ/ Departamenti	Niveli organizativ/Divizioni	Nëpunësit sipas rregulloreve	Nëpunësit aktual
Kabineti i Ministrit			22
Sekretarit të Përgjithshëm	Njësia e Auditimit të Brendshëm	4	3
	Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	5	5
	Divizioni për Prokurim Publik	3	4
	Divizioni për Komunikim me Publikun	5	4
	Divizioni për Buxhet dhe Financa	11	11
	Divizioni për Planifikim dhe Koordinim të Politikave	3	3
	Qendra për Menaxhimin e Krizave	4	3
Departamenti për Evropë, BE dhe Rajon	Divizioni për Evropë dhe BE	7	4
	Divizioni për Rajon	6	7

54 Rregullore (ZKM) Nr. 01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, miratuar nga Kryeministri me Vendimin nr. 214/2022, të datës 01.02.2022.

55 Pozitë e rregullt nënkupton kur pozita ushtrohet nga nëpunsi civil, i cili është emëruar dhe ka një akt emërim të ligjshëm për ushtrimin e asaj pozite.

56 Rregullore (ZKM) Nr. 01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, miratuar nga Kryeministri me Vendimin nr. 214/2022, të datës 01.02.2022.

Departamenti për Amerikë	Divizioni për Amerikën Veriore	3	1
	Divizioni për Amerikën Qendrore dhe atë Jugore	3	1
Departamenti për Afrikë dhe Lindje të Mesme	Divizioni për Afrikën Veriore dhe Lindjen e Mesme	3	3
	Divizioni për Afrikën Nënsahariane	4	3
Departamenti për Azi dhe Oqeani	Divizioni për Azinë	4	2
	Divizioni për Azinë Juglindore dhe Oqeaninë	3	3
Departamenti për Organizata Ndërkombëtare	Divizioni për Organizata Ndërkombëtare	3	2
	Divizioni për Organizatën e Kombeve të Bashkuara	3	2
	Divizioni për të Drejtat e Njeriut dhe Çështje Humanitare	3	3
Departamenti për NATO dhe Politika të Sigurisë	Divizioni për NATO	3	1
	Divizioni për Politika të Sigurisë	3	0
Departamenti për Diplomaci Ekonomike	Divizioni për Promovim dhe Përkrahje të Investimeve	3	2
	Divizioni për Bashkëpunim Ekonomik Ndërkombëtar	3	3
Departamenti për Diplomaci Publike	Divizioni për Diplomaci Publike dhe Digjitale	3	0
	Divizioni për Diplomaci Kulturore dhe Sportive	3	0
Departamenti për Diasporë	Divizioni për Koordinim dhe Komunikim me Diasporë	3	3
	Divizioni për Kulturë, Rini dhe Sport në Diasporë	5	5
	Divizioni për Arsim në Diasporë	5	5
Departamenti i Protokollit të Shtetit	Divizioni i Ceremonialit	4	5
	Divizioni për Korrespondenca dhe Privilegje Diplomatike	4	2

Departamenti për Çështje Ligjore dhe Traktate	Divizioni për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit	4	4
	Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve, Mbështetjes Ligjore dhe Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit	3	2
	Divizioni për Traktate dhe Marrëveshje Ndërkombëtare	3	4
Departamenti për Shërbime të Përgjithshme	Divizioni për Teknologji Informative	5	2
	Divizioni për Logjistikë dhe Shërbime	17	15
	Divizioni për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv	3	3
Departamenti për Çështje Konsullore	Divizioni për Politika Konsullore	3	3
	Divizioni për Shërbime Konsullore	10	9
	Divizioni për Viza	3	3

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Historiku

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është themeluar me Rregulloren Nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, të UNMIK, të datës 13 shtator 2001. Si e tillë, kjo Ministri ka qenë përgjegjëse për krijimin e politikave dhe zbatimin e ligjeve për zhvillimin e bujqësise, lehtësimin e zhvillimit të skemës kreditore për mbështëtje të bujqësisë, pylltarisë dhe aktiviteteve për zhvillimin rurla në sektorin privat, krijimin e politikave për të ndihmuar administrimin dhe menaxhimin e sektorit të pylltarisë, duke përfshirë edhe mbrojtjen, aktivitetet e ripyllëzimit, vetëmbajtjen, luftimin nga zjarri, etj. Aktualisht Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka të njejtin mandat.

Organizimi

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka gjithsejt 9 departamente dhe 29 divizione me aktualisht 154 të punësuar.

Ushtruesit e Detyrës

Nga 9 departamente 7 pozita udhëhiqen me ushtrues detyre, ndërsa departamentet tjera udhëhiqen nga persona të emëruar në pozita të rregullta[57].

Gjendja pas ristrukturimit

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka mbetur e paprekur nga procesi i ristrukturimit.

Tabela [...]

Niveli Organizativ/ Departamenti	Niveli organizativ/Divizioni	Nëpunësit sipas rregulloreve	Nëpunësit aktual
Kabineti I Ministrit	Kabineti i Ministrit		17
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm	Divizioni i Auditimit të Brendshëm	4	3
	Divizioni i Prokurimit	1	3
	Njësia e Drejtave të Njeriut		
	Zyra e Sekretarit		4
	Divizioni për Komunikim Publik	2	2
Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural - Autoritetin Menaxhues DZHR&AM	Divizioni për Programim dhe Koordinim të Zhvillimit Rural	4	3
	Divizioni për Aftësitë Konkurruese, Diversifikim dhe LEADER	4	4
	Divizioni për Politika Agro-Mjedisore dhe Viset më Pak të Favorizuara	1	1
	Divizioni për Asistencë Teknike, Komunikim dhe Publicitet		1
	Divizioni për Monitorim, Vlerësim dhe Raportim për Zhvillimin Rural	3	2
Departamenti për Politika Bujqësore, dhe Tregjeve	Divizioni për Përkrahje Direkte, Politika dhe Tregjeve	3	2
	Divizioni për Prodhimtari Bimore dhe Ujitje;	9	4
	Divizioni i Mbrojtjes së Bimëve	5	3
	Divizioni i Blegtorisë	7	3
	Divizioni i Shfrytëzimit të Tokave, GIS, Regjistrat, LPIS	2	4

57 Pozitë e rregulltë nënkupton kur në pozita ushtrohet nga nëpunsi civil I cili është emruar dhe ka një akt emërim të ligjshëm për ushtrimin e asaj pozite.

Departamenti i Pylltarisë	Divizioni për Politikat e Pylltarisë, Arsimim dhe Hulumtim	2	0
	Divizioni për Menaxhimin e Zonave të Mbrojtura dhe Gjueti	2	2
	Divizioni për Menaxhimin e Pyjeve dhe Infrastrukturë në Pylltar	2	2
Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike	Divizioni i Shërbimeve Teknike	47	4
	Divizioni i Shërbimeve Fushore të Ekstensionit	3	9
	Divizioni i për Informim, Bashkëpunim, Monitorim dhe Trajnim	4	2
Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore	Divizioni i Analizave Ekonomike	4	2
	Divizioni i Statistikave Bujqësore	3	3
● Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari	Divizioni i Vreshtarisë	3	1
	● Divizioni i Vertarisë	3	1
	Divizioni për paralajmërim të Hershëm të Sëmundjeve dhe Dëmtuesve	3	0
	Divizioni i Laboratorit për Analiza Kimike në Verë	3	2
Departamenti për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave	Divizioni për Integrime Evropiane	1	1
	Divizioni për Koordinim të Politikave	1	2
Instituti Bujqësor i Kosovës -Pejë	IBK në Pejë		29
● Departamenti Ligjor	Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit	1	2
	Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit	1	1
Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme	Divizioni për Burime Njerëzore	3	3
	● Divizioni për Buxhet dhe Financa	5	8
	● Divizioni për TI dhe Shërbime Logjistike	14	9

● Ushtrues i detyrës Totali 150 122

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Historiku

Ministria e Shëndetësisë fillimisht është themeluar me Rregulloren Nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, të UNMIK, të datës 13 shtator 2001, si Ministria e Shëndetësisë, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. E njejta ka qenë përgjegjëse për krijimin e politikave dhe zbatimin e ligjeve të të tri fushave, pra në fushën e shëndetësisë, mjedisit

dhe planifikimit hapësinor. Ndërsa, për momentin e njeta mban emrin si Ministria e Shëndetësisë dhe dikasteri i mjedisit dhe planifikimit hapësinor tanimë janë pjesë të minsitrive të ndryshme. Sot, Minsitria e Shëndetësisë është përgjegjëse vetëm për këtë dikaster në aspektin e krijimit të politikave, implementimit të ligjeve, koordinimin e aktiviteteve në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjen e jedisit, etj. Ndërsa, sektori i mjedisit dhe planifikimit hapësinor tanimë janë pjesë e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Organizimi

MSh ka gjithsejt 7 departamente dhe 19 divizione me aktualisht 147 të punësuar.

Ushtruesit e Detyrës

Nga 7 departamente 2 pozita udhëhiqet me ushtrues detyre, ndërsa departamentet tjera udhëhiqen nga persona të emëruar në pozita të rregullta[58]. Momentalisht edhe Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm udhëhiqet me ushtrues detyre.

Gjendja pas ristrukturimit

Ministria e Shëndetësisë (MSH) ka mbetur e paprekur nga procesi i ristrukturimit të fundit. Mirëpo për të njëjtën në korrik të vitit 2024, është miratuar rregullorja e për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.[59] Nga kjo rregullore janë të përjashtuara agjencitë ekzekutive dhe institucionet vartëse të adminisratës shtetërore që bien në kompetencën e MSh-së. Megjithatë, sipas përgjigjes së MSH-së, ende nuk është bërë riorganizimi bazuar në rregulloren e re.

Tabela [...]

Niveli Organizativ/ Departamenti	Nëpunësit sipas rregulloreve	Nëpunësit sipas rregulloreve	Nëpunësit aktual
Kabineti I Ministrit			17
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm	Divizioni i Auditimit të Brendshëm	4	3
	Divizioni i Kujdesit Parësor Shëndetësor	11	7
	Divizioni Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	3	1
	Divizioni i Farmacisë	6	9
	Divizioni i Prokurimit;	4	5
	Divizioni për Komunikim Publik	5	5
Departamenti për Planifikim Strategjik Shëndetësor	Divizioni i Planifikimit Strategjik	3	6
	Divizioni i të Drejtave të Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor	3	4

58 Pozitë e rregullt nënkupton kur në pozita ushtrohet nga nëpunsi civil I cili është emruar dhe ka një akt emërim të ligjshëm për ushtrimin e asaj pozite.

59 https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/07/Rregullorja-ZKM-Nr.-15-2024.pdf

Departamenti i Shërbimeve Shëndetësore dhe Shëndet Publik	Divizioni i Shëndetit Mendor	2	2
	Divizioni i Shëndetit të Nënës dhe Fëmijës	2	1
	Divizioni i Shërbimeve të Veçanta Shëndetësore	4	2
	● Divizioni i Infermierisë	7	3
● **Departamenti i Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISh)**	Divizioni i Planifikimit Strategjik të SISh	2	4
	● Divizioni i Mbikëqyrjes së Funksionimit Operativ të SISh	8	3
Departamenti për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave	Divizioni për Integrime Evropiane	2	4
	Divizioni për Koordinimin e Politikave	3	2
